



**Raporti
Vjetor 2014**



Banka

Ekonomike

PËRMBAJTJE

Mesazhi nga Kryeshefja Ekzekutive	4
Struktura Organizative e Bankës	6
Vizioni	7
Misioni	7
Shkurtimisht mbi Bankën Ekonomike	8
Mjedisi Makroekonomik në Kosovë	9
Ekonomia reale	9
Sektori Bankar	9
Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës	10
Pjesëmarrja në Kredi	10
Pjesëmarrja në Depozita	10
Pasqyra e pozitës financiare	12
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	13
Përformanca e Bankës Ekonomike	14
Asetet e bankës	15
Ecuria e Kredive	15
Ecuria e Depozitave	16
Të hyrat nga Interesi dhe Jo Interesi	16
Shpenzimet operative	17
Thesari	19
Menaxhimi i Likuiditetit dhe riskut	19
Menaxhimi i rrezikut të valutës	19
Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës	19
Zhvillimi i Biznesit	20
Kreditë gjithsej	20
Mikro bizneset	22
Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	23
Klientët individual	23
Zhvillimi i produkteve dhe Marketingu	24
Kanalet e distribuimit	25
Rrjeti i Degëve	25
Kanalet alternative të distribuimit	26
Kujdesi ndaj klientëve	27
Menaxhimi i riskut	28
Risku Kreditor	29
Ekspozimi nga rreziku i normës së interesit	29
Risku Operacional	29
Operacionet	30
Transferet vendore	30
Transferet ndërkombëtare	31
Letërkreditë dhe garancionet ndërkombëtare	31
Teknologjia Informative	32
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit	33
Pasqyrat Financiare sipas BQK-së	34

Mesazhi nga Kryeshefja Ekzekutive

Përderisa viti 2014 ishte një vit mjaft sfidues në përgjithësi, kam kënaqësinë të ju njoftoj se ka qenë një vit mjaft i suksesshëm për Bankën Ekonomike.

Banka Ekonomike ka vazhduar trendin e rritjes dhe ka arritur rezultate mjaft të mira në të gjithë indikatorët kyç të afarizmit financiar.



Gjatë vitit që lëmë pas, ne kemi pasur likuiditet të shkëlqyeshëm, dhe fokusi ynë kryesor ishte rritja e kujdeshme në kredi, diversifikim i portfolios me fokus të veçantë në kredi për Individë dhe Biznese të vogla/mesme. Banka Ekonomike vazhdon të shërbejë dhe plotësojë nevojat dhe kërkesat e të gjithë klientëve tanë, qoftë Individë apo biznese.

Gjatë vitit 2014 Banka ka rritur portofolion e kredive për 8 milion Euro, respektivisht rritje prej 7%, rritje e të hyrave neto nga interesi për 1,408 milion euro, apo 19,68%, rritje e të hyrave neto nga shërbimet për 308 mijë euro, respektivisht 15.04%.

Përkundër, që kemi vazhduar të kemi nivel të lartë të rezervave neto nga kreditë, respektivisht nivel i dyfishuar krahasuar me vitin paraprak, falë rritjes së kujdeshme të të hyrave neto dhe menaxhimit efikas të shpenzimeve, Banka Ekonomike ka arritur të përmbyllë vitin me një fitim (para tatimit) prej 1,068 mijë euro.

Rrjedhimisht, gjatë vitit 2014 Banka ka arritur të përmirësoj edhe disa indikator kyç të pajtueshmërisë/rregullativave ligjore, respektivisht përmirësim i CAR (Raporti i adekuatshmëris së kapitalit) nga 12.19% në vitin 2013 në 12.96% në vitin 2014.


Gjatë vitit 2014 është përgatitur Plani Strategjik i Bankës për periudhën 2015-2018, dokument ky i cili do të jetë udhërrëfyes i punës sonë për vitet e ardhshme. Është bërë ri-organizmi i Bankës dhe strukturë e re organizative konform strategjisë së Bankës, me fokus të veçantë në sektorin retail, rritje e shfrytëzueshmërisë së kanaleve alternative dhe forcimi i kontrolleve të brendshme. Rrjedhimisht, përmirësimi i kontrolleve të brendshme mbetet një nga prioritetet e Bankës.

Ne do të vazhdojmë të jemi aktiv në kreditim, në rritje të kujdeshme në kredi, duke zbatuar standarde të larta të menaxhimit të të gjitha rreziqeve bankare.

Përfundimisht, në emër të ekzekutivit të Bankës Ekonomike dëshiroj të falënderoj të gjithë punonjësit e Bankës për arritjen e rezultateve, pa angazhimin, përkushtimin dhe besnikërinë e të cilëve këto rezultate do ishin të pamundura.

Merita Gjyshinca Peja
Kryeshefe Ekzekutive

Struktura Organizative e Bankës



Vizioni

Bankë e orientuar në rritje të qëndrueshme dhe kualitative, shërbime cilësore dhe standarde të larta profesionale.

Misioni

Bankë vendore MODEL duke:

- M**undësuar klientëve qasje të lehtë dhe të shpejtë tek produktet e diversifikuara bankare, duke ngritur vlerën për klientët, të punësuarit dhe aksionarët;
- O** frues vendas modern i shërbimeve elektronike bankare;
- D** eterminim në ngritje profesionale për të punësuarit tanë;
- E** tika, respekti dhe puna ekipore janë vlerat tona;
- L** igjet, politikat dhe procedurat respektohen me përpikëri!



Shkurtimisht mbi Bankën Ekonomike

Banka Ekonomike është licencuar më 28.05.2001, ndërsa punën e ka filluar në fillim të qershorit të po këtij viti. Nga momenti i licencimit, Banka Ekonomike, ka pësuar ndryshime të rëndësishme, në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe është banka e vetme me 100% kapital vendor.

Banka Ekonomike ka një rrjetë të zhvilluar në mënyrë graduale dhe të shpërndarë në gjithë territorin e Kosovës. Gjatë vitit 2014 Banka Ekonomike kishte 39 njësi bankare, nga të cilat, shtatë degë janë në qendrat kryesore të Kosovës dhe 32 nëndegë gravitojnë nëpër njësitë më të vogla regjionale.

Banka Ekonomike ka investuar në vazhdimësi në burimet njerëzore, si faktorin përcaktues të lëvizjes së gjithë treguesve tjerë.

Në fund të vitit 2014 Banka Ekonomike kishte 321 punëtorë.

Mjedisi Makroekonomik në Kosovë

Ekonomia reale

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2014, ishte 3.0 përqind, që përkon me një ndër normat më të larta të rritjes ekonomike në rajon. Kjo rritje u përcaktua nga ecuria pozitive e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Rritja e konsumit gjatë vitit 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së remitançave dhe kredive, si dhe rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë. Investimeve në vitin 2014 u karakterizuan me rënie të konsiderueshme, kryesisht për shkak të rënies së investimeve publike. Në të njëjtën periudhë, thellimi i deficitit tregtar të mallrave ka ndikuar që neto eksportet gjatë vitit 2014 të kontribuojnë negativisht në rritjen e PBB-së. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave gjatë vitit 2014, niveli shumë më i lartë i importit ka bërë që neto eksportet të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike.

Sektori Bankar

Sektori bankar i Kosovës shënoi rritje të theksuar të profitit gjatë vitit 2014. Neto profiti i realizuar gjatë këtij viti shënoi vlerën 60.1 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 26.0 milionë në vitin 2013. Vlera e gjithsej asetëve të sektorit bankar në dhjetor 2014 arriti në 3.18 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.2 përqind.

Njëkohësisht struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat

përbëjnë 72.8 përqind të gjithsej depozitave. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve që kanë një pjesëmarrje prej 22.1 përqind. Ndërsa, depozitat tjera mbesin kategoria më e vogël me pjesëmarrje prej 5.1 përqind në gjithsej depozitat e sektorit bankar. Gjithsej depozitat në sektorin bankar në dhjetor 2014 arritën vlerën 2.53 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.6 përqind.

Ndërkaq si kategori kryesore e asetëve të sektorit bankar kreditimi gjatë vitit 2014 u karakterizua gjithashtu me një rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin paraprak. Në dhjetor 2014, gjithsej kreditë arritën vlerën 1.88 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.2 përqind (2.4 përqind në vitin 2013).

Kreditë e reja të lëshuara në vitin 2014 arritën vlerën prej 993.9 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 30.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 2.4 përqind në vitin 2013.

Kjo sugjeron që rimëkëmbja e aktivitetit kreditues do të vazhdojë edhe gjatë vitit në

vijim. Në kuadër të gjithsej kredive aktive, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar prej 12.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.9 përqind në dhjetor 2013. Sidoqoftë, përshpejtimi i rritjes nuk vërehet edhe te kreditë për ndërmarrjet të cilat shënuan normë të ngjashme të rritjes krahasuar me vitin e kaluar.¹


¹ Informatat në vijim bazohen në materialet e publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës

Pjesëmarrja në Kredi

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total kreditë në treg, me datën 31 Dhjetor 2014 ka qenë 6.53 % të total sektorit bankar (6.43% në vitit 2013).


Figura 1: Pjesëmarrja sipas Bankave në total kreditë/paradhënie, 31 Dhjetor '14



Pjesëmarrja në Depozita

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total depozitat në treg, me datën 31 Dhjetor 2014 ka qenë 6.26% të total sektorit bankar në Kosovë (6.77% në vitit 2013).

Figura 2: Pjesëmarrja e Bankave në total depozitat, 31 Dhjetor '14



Shënim: analiza e tregut është bazuar në të dhënat financiare të publikuara nga Bankat Komerciale (sipas rregullave të Bankës Qendrore të Kosovës, BQK).

Pasuritë/Aktiva e përgjithshme e Bankës Ekonomike deri me datën 31 Dhjetor 2014 ka qenë 172,697,719.24 Euro. Pjesëmarrja e përgjithshme e Bankës Ekonomike në total tregun është 5.90%.

Siç mund të shihet, gjatë vitit 2014 Banka ka rritur pjesëmarrjen në treg tek kreditë, vlen të përmendet që sukses i veçantë ka qenë tremujori i fundit i vitit 2014, T4, me ç'rast tregu është rritur për 1.5%, ndërsa Banka Ekonomike 6.5%. Ky është një tregues i mirë, që na bënë të besojmë që ky trend dhe ndryshimet e bëra do të na mundësojnë të rrisim pjesëmarrjen në treg përgjatë periudhave në vijim.

Gjatë vitit 2014 Banka ka përmirësuar gjithashtu (CIR) raportin e të hyrave neto në raport me shpenzimet, rrjedhimisht ky raport është përmirësuar nga 74% në 65%. Me përmirësimin e proceseve të Bankës, dhe optimizim të kostove, Banka Ekonomike në vazhdimësi do të përmirësoj këtë indikator me rëndësi.




Figura 3: Raporti i të hyrave me shpenzimet, CIR, 2013 dhe 2014

Pasqyra e pozitës financiare

	2014	2013
Paraja në dorë dhe në banka	15,403	14,535
Balancat me BQK-në	10,915	38,095
Kreditë e dhëna klientëve	110,812	103,890
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	28,141	13,934
Prona dhe paisjet	6,388	6,957
Pasuria e paprekshme	306	68
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e korporates	146	228
Tatimit i shtyrë në pasuri	-	117
Pasurit tjera	586	506
Gjithsej pasuritë	172,697	178,330
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	157,353	164,631
Borxhi varur	1,050	-
Të hyrat të shtyera	331	559
Llogarit e pagueshme	409	528
Gjithsej Detyrimet	159,143	165,718
Kapitali dhe rezervat		
Kapitali aksionar	14,778	14,778
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	102	102
(Humbjet) Akumuluar	(1,326)	(2,268)
Gjithsej kapitali dhe rezervat	13,554	12,612
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat	172,697	178,330

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Të hyrat nga interesi:	2014	2013
Nga kreditë e dhëna klientëve	12,610	12,794
Nga depozitat dhe balancat me bankat	2	13
Interesi nga investimet e mbajtura deri në maturim	326	142
	12,938	12,949
Shpenzimet e interesit		
Shpenzimet e interesit nga detyrimet	(4,066)	(5,557)
Borxhet e varura	(50)	-
	(4,116)	(5,557)
Neto të hyrat nga interesi	8,822	7,392
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	2,491	2,048
Komisionet dhe tarifat (shpenzimet)	(396)	(276)
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat	2,095	1,772
Të hyrat tjera operuese	48	33
Fitimet neto nga valutat e huaja	(6)	28
Gjithsej të hyrat	10,959	9,225
Shpenzimet tjera operuese	(6,994)	(6,828)
Provizionimi për humbjet nga kreditë	(2,897)	(1,305)
Gjithsej shpenzimet operuese	(9,891)	(8,133)
Fitimi para tatimit	1,068	1,092
Shpenzimet e tatimit	(127)	117
Neto fitimi për vitin	941	1,209
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	941	1,209

E aprovuar që të lëshohet në emër të menaxhmentit të Banka Ekonomike Sh.a. dhe e nënshkruar në emër të tyre më 16 Prill 2015:

Merita Gjyshinca Peja
Kryeshefe Ekzekutive



Syzane Kaçaniku
Menaxhere e Departamentit
të Financave





Përformanca e Bankës Ekonomike

Afarizmi i bankës në vitin 2014 ka qenë pozitiv. Të hyrat neto nga interesi kanë pësuar rritje prej 1,408 milion Euro, respektivisht, 19,68% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Kjo vjen kryesisht si rezultat i uljes së kostove të depozitave. Gjithashtu ka pasur rritje të të hyrave nga shërbimet për 308 mijë Euro, apo 15,04%.

Me gjithë faktin që niveli i rezervave është dyfishuar në raport me vitin paraprak, respektivisht 3,006 milion rezerva neto në vitin 2014, krahasuar me 1,427 milion në vitin 2013, banka ka arritur të përmbyll vitin me mjaft sukses, respektivisht, fitimi para tatimit ka qenë 1,068 milion Euro.




Figura 4: Asetet e Bankës Ekonomike, 2010-2014; Të gjithë numrat janë në '000 Euro!

Asetet e bankës

Asetet e Bankës kanë pësuar një rënie të lehtë prej 3.12%. Rënia është si rezultat i rënies së lehtë të depozitave, megjithëse Banka vazhdon të ketë një pozicion të

shkëlqyeshëm të likuiditetit, dhe se kjo rënie ka qenë konform objektivave dhe parashikimeve të Bankës për vitin 2014 për menaxhim sa më efektiv të portfolios. Pjesëmarrja e BEK në treg sa i përket aseteve është 5.90 %.




Figura 5: Portfolio i kredive, 2010-2014; Të gjithë numrat janë në '000 Euro!

Ecuria e Kredive

Me angazhimin e vazhdueshëm të Bankës Ekonomike, portfolio e kredive ka shënuar rritje në vazhdimësi dhe të qëndrueshme

përgjatë gjitha periudhave të vitit, dhe duke përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2014, portfolio e kredive është rritur nga 112.5 milion kredi, në 120.7 milion në fund të vitit 2014.

Ecuria e Depozitave

Portfolio e depozitave të bankës përbëhet nga një bazë e fuqishme dhe e qëndrueshme e klientëve, që vijnë kryesisht nga radha e personave fizik.




Figura 6: Depozitat e klientëve, Banka Ekonomike, 2010- 2014; Të gjithë numrat janë në''000 Euro!

Në fund të vitit 2014 niveli i depozitave në Bankën Ekonomike, ka arritur vlerën 155,014,746. Ecuria e depozitave ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2010 deri në vitin 2013, gjegjësisht viti 2014 ka rezultuar me stabilitet të depozitorëve dhe krahas strategjisë së bankës, e kemi ulë nivelin e depozitave për të mirëmbajtur raportin kredi/ depozita si rezultat i likuiditetit të mjaftueshëm.

Gjatë vitit 2014 Banka ka qenë e fokusuar më shumë në menaxhimin efektiv të depozitave dhe sigurimin e profitabilitet për çdo depozitë të mbajtur. Vlen të theksohet që Depozitat në fund të vitit kanë tejkaluar objektivat e përcaktuara, duke mbajtur një nivel të shkëlqyeshëm të raportit të kredive me depozita prej 77.9 %.

Të hyrat nga Interesi dhe Jo Interesi

Euro '000	2010	2011	2012	2013	2014
Te hyrat nga Interesi	9,331	11,636	12,249	12,710	12,677
Kostot e Depozitave	3,626	4,859	5,398	5,557	4,116
Te hyrat NETO nga Interesi	5,705	6,777	6,851	7,153	8,561
Te hyrat NETO JO nga Interesi	1,781	2,127	2,421	2,352	2,525





Figura 7 & 8: Të hyrat Neto nga Interesi dhe Jo Interesi, 2010-2014; Të gjithë numrat janë në''000 Euro!

Shpenzimet operative

<i>Euro '000</i>	2010	2011	2012	2013	2014
<i>Shpenzimet Administrative</i>	2,278	2,618	3,083	3,380	3,598
<i>Shpenzimet e personelit</i>	2,180	2,640	2,639	2,454	2,520
Gjithsej Shpenzimet Operative	4,458	5,258	5,722	5,834	6,118




Figura 9: Shpenzimet Operative, 2010- 2014; Të gjithë numrat janë në'000 Euro!

Gjatë vitit 2014 kemi pasur një rritje të lehtë të shpenzimeve operative. Rritja e shpenzimeve administrative ka rrjedh si rezultat i zgjerimit të hapësirave të bankës ku këtu përfshihen marrja e dy lokaleve të reja, rritja e shpenzimeve të mirëmbajtjes së softuerit (qendrës procesuese), shpenzimet e sigurisë fizike dhe TPG-së, shpenzimet për Visa dhe MasterCard si dhe rritjes së shpenzimeve për shërbime të konsulencës.



Dow Jones 30 Industrials

Dow Jones 30 Industrials
+4.71%

Menaxhimi i Likuiditetit dhe riskut

Viti 2014 ishte i suksesshëm sa i përket menaxhimit dhe konsolidimit të depozitave. Likuiditeti i bankës vazhdon të mbetet në nivel të qëndrueshëm, duke ulur kostot e financimit. Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit bëhet përmes politikave dhe procedurave të saj dhe në përputhje me kërkesat e BQK-së. Banka në vazhdimësi ka mbajtur nivel të mjaftueshme të likuiditetit, duke aplikuar standardet globale të likuiditetit. Gjatë vitit 2014 teprica e likuiditetit të bankës është investuar në bankat kryesisht me klasifikim të klasit parë, kemi bërë investime në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës duke iu shmangur rrezikut të tregut ndërkombëtar.

Banka Ekonomike ka implementuar metoda të avancuara për matje dhe menaxhim për parashikimin e likuiditetit, përfshirë stres testet e likuiditetit në disa skenarë, nga ato më reale dhe ato më të përkeqësuar, kjo ndihmon bankën për t'i analizuar pozicionet e saj të likuiditetit në rast të ndonjë tronditje potenciale qoftë e brendshme apo krizë e tregut.

Në vitin 2014, duke u mbështetur në nivel të qëndrueshëm të mjeteve likuidite, banka në vazhdimësi ka ulur kostot e financimit, rrjedhimisht u është mundësuar klientëve kredi me norma më të ulëta të interesit.

Menaxhimi i rrezikut të valutës

Rreziku i valutës së huaj menaxhohet në pajtim me politikat e menaxhimit të valutave të huaja, po ashtu me rregulloret e BQK-së për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja. Banka Ekonomike ka një nivel të ulët të ekspozimit ndaj rrezikut të valutës për të shmangur rreziqet nga spekulimet. Pozitat e valutës menaxhohen në baza ditore dhe normat e këmbimit të valutave të huaja monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Tregu i përgjithshëm i portfolios së Bonove të Thesarit dhe Obligacioneve të Qeverisë së Kosovës ka shënuar rritje, ku vlera e emetuar në vitin 2014 ka qenë 259.5 milion euro ndërsa në vitin 2013 ka qenë 154.2 milion euro, pra ka një rritje prej 105 mil euro të vlerës së emetuar. Në vitin 2014 Qeveria ka filluar të emeton edhe Obligacione për periudhë 2 vjeçare, pasi që emetimet kanë qenë vetëm në periudhë afat shkurtë në Bono të Thesarit. Banka Ekonomike ka qenë mjaft aktive në tregun lokal të investimeve në letra me vlerë, me ç'rast kemi pas investime gjatë vitit 2014 rreth 46 milion euro, një rritje prej 23% në krahasim me vitin 2013.

<i>Euro '000</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>Ndryshimi në vlerë</i>	<i>Ndryshimi në %</i>
Investime në Letra me Vlerë	37,650	46,040	8.3 mio	22

Zhvillimi i Biznesit

Duke qenë të vetëdijshëm për nevojën për të qenë sa më afër klientëve dhe identifikimit të nevojave të tyre, kemi ndërmarr disa aktivitete të cilat karakterizohen si të domosdoshme për zhvillim sa më të qëndrueshëm të biznesit.

Në aspekt të riorganizimit të departamentit të biznesit kemi bërë ndryshime të cilat ndërlidhen me strukturën organizative ku nga një strukturë e centralizuar e departamentit të Biznesit është ndarë në disa departamente respektive të cilat janë përgjegjëse për: klientët e biznesit, klientët privat, strukturë e veçantë për kanale të shitjes, gjithashtu edhe departamenti i marketingut ka të inkorporuar edhe zhvillimin e produkteve si njësi e veçantë. Kjo strukturë organizative do të na mundësoj që të jemi më të fokusuar tek grupet e klientëve dhe proceset në përgjithësi.

Në vazhden e ri-organizimit të zhvillimit të biznesit dhe rritjes së portfolios kreditore është identifikuar si e domosdoshme rritja e numrit të stafit të cilët merren drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimeve kreditore për klientë. Rrjedhimisht, një numër i stafit nga pozitat e tjera kanë kaluar në pozita të analisteve kreditor, me ç'rast reflektohet edhe në rritjen e portfolios kreditore. Në këtë rast vlen të përmendët që me numër të njëjtë të stafit në degë, por me një ri-organizim kemi arritur të rrisim produktivitetin për degë.

Në mënyrë që stafi i cili merret me zhvillimin e biznesit të jetë sa më i kompletuar në aspektin e përgjegjësive, është bërë edhe rivlerësimi i detyrave të punës, me ç'rast janë shtuar përgjegjësi shtesë të cilat kanë të bëjnë me rritje të produktivitetit, kualitet të portfolios dhe respektim të politikave dhe procedurave.

Gjithashtu janë përcaktuar edhe objektivat (Management By Objectives) të cilat duhet të jenë edhe udhërrëfyes për secilin menaxher dhe vartësit e tyre konform synimeve të institucionit. Gjatë pjesës së dytë të vitit në vazhdimësi të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me motivimin e stafit, kemi implementuar edhe strukturën e insentivave, përfshirë insentivat financiare dhe jofinanciare, si: skemën e bonusave, përzgjedhja e stafit më të mirë (certifikata), dhe organizime të ndryshme.

Kreditë gjithsej

Gjatë vitit 2014 kemi pasur rritje në kredi prej 8 milion euro, ose 7.5 %. Rritja kryesisht ka ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2014, kryesisht si rezultat i aktiviteteve të intensifikuara duke përfshirë fushata të ndryshme për produktet kreditore të destinuar për klientët individual dhe njëkohësisht për klientët e biznesit. Këto fushata të marketingut, si synim kryesor

kanë qasjen ndaj klientëve me produktet e profilizuara të cilat janë komplementuar me shërbimet elektronike ekzistuese dhe të reja. Këtu vlen të përmendet avancimi i kartelave tona të kreditit të cilat plotësojnë nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë.

Angazhimi i bankës Ekonomike tregohet edhe në zhvillimin e portfolios ndër vite, me një ndryshim të theksuar në vitin 2014, duke përfshirë klientët individual dhe ata të biznesit. E gjithë kjo pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Kreditë

<i>Outstanding ne '000</i>	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Persona fizik	18,941 €	28,329 €	26,764 €	29,298 €	35,136 €
Persona juridik	71,292 €	69,225 €	76,740 €	83,220 €	85,625 €
Totali I portfolios	90,233 €	97,555 €	103,504 €	112,518 €	120,761 €




Figura 10 :Totali i portfolios së kredive , 2010-2014; Te gjithë numrat jane ne''000 Euro!

Gjatë vitit 2014, Banka Ekonomike, ka intensifikuar angazhimet në diversifikimin e portfolios duke u koncentruar tek mikro biznese dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, njëkohësisht fokus i veçantë i është kushtuar klientëve individual.

KREDITE SIPAS SHUMAVE	Dhjetor'13	Dhjetor'13 %	Dhjetor'14	Dhjetor'14 %
Deri ne 100K	43,827	39%	51,454	43%
Mbi 100 deri 500k	26,514	24%	30,269	25%
Mbi 500k	19,231	17%	15,792	13%
OVD BUS & PI	22,946	20%	23,246	19%
Total Portofoli	112,518	100%	120,761	100%

KREDITE SIPAS SEGMENTEVE	Dhjetor'13	Dhjetor'13 %	Dhjetor'14	Dhjetor'14 %
Individe	29,298	26%	35,136	29%
Biznese	83,220	74%	85,625	71%
Total Portofoli	112,518	100%	120,761	100%



Mikro bizneset

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vazhdojnë të luajnë rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen ekonomike të vendit. Duke marrë parasysh këtë fakt Banka Ekonomike ka ofruar shërbime kreditore dhe njëkohësisht ka intensifikuar angazhimin në ofrimin e shërbimeve jo-kreditore në mënyre që të jemi në përputhje dhe përmbushje të nevojave të këtyre klientëve të cilët shihen me potencial, e gjithë kjo me qëllim të përkrahjes në zgjerimin e këtij segmenti të biznesit.

Gjatë vitit 2014 Banka Ekonomike ka vazhduar të dëshmojë se është partner i besueshëm financiar, dhe institucion i cili përkrah klientët e rijnë dhe ata ekzistues, përmes stafit profesional i cili është në gjendje të ofroj shërbim të nivelit të lartë. Krahas shërbimit, fokus i veçantë dhe angazhim maksimal është dedikuar identifikimit të nevojave të klientëve. E gjithë kjo me qëllim të këshillimit të klientëve në investimet ekzistuese dhe të reja. Në mënyrë që të sigurojmë mbarëvajtjen e procesit i gjithë stafi është profilizuar në segmentet e caktuara përkatëse.

I gjithë ky angazhim shprehet edhe përmes numrit të klientëve i cili është rritur gjatë viti 2014.

Krahas zhvillimit të tregut banka ka ndërmarrë gjithashtu hapa të brendshëm në përpilimin dhe përshtatjen e politikave të saja të brendshme me nevojat dhe avancimin e sistemit të bizneseve. Përputhja e qëllimeve të dyanshme njëkohësisht shihet edhe në rritje të konsiderueshme të portfolios kreditore në këtë segment. Portfolio në këtë segment është zhvilluar tutje dhe ka derivuar rezultate për 13% më të mira se në vitin paraprak.

Në vazhden e rritjes së bashkëpunimit nëpërmes proceseve të ndryshme kemi punuar shumë në drejtim të rritjes së transparencës së bizneseve, proces i cili ka rezultuar në rritjen e vetëdijesimit dhe kulturës financiare. Kjo mbetet objektivë e vazhdueshme të cilën banka do ta forcojë edhe në vitet në vazhdim përmes faktorëve të ndryshëm nxitës në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh të gjithë angazhimin, Banka Ekonomike ka rritur dukshëm prezencën e saj në tregun e Kosovës, gjithmonë me qëllim të krijimit të qasjeve në fonde të cilat dedikohen dhe përdoren për qëllim të zhvillimit dhe krijimit të asetëve shtesë për biznesin.

Banka Ekonomike është e vendosur fuqimisht të identifikohet si institucion financiar Model, e cila përbëhet tërësisht prej kapitalit vendor.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Banka Ekonomike ka përcaktuar strukturën organizative dhe operacionale të kreditimit për bizneset e segmentit të NVM. Produktet kreditore që i ofrohen këtij segmenti, dhe organizimin e brendshëm në lidhje me procesin e kreditimit janë përshtatur në mënyrë që të plotësojnë dhe përkrahin biznesit e këtij segmenti.

Në mënyrë që Banka të jetë në përputhshmëri të plotë me ndryshimet në treg kemi qenë mjaft të fokusuar edhe në zhvillimin e kanaleve alternative, të cilat kanë rezultuar me efikasitet në shërbimin ndaj klientëve.

Duke marrë parasysh volumin e ekspozimeve kreditore në këtë segment, mirëmbajtja dhe zhvillimi i marrëdhënieve afatgjata është më se i nevojshëm.

Duke ofruar shërbime kreditore segmentit të NVM, banka në mënyrë të drejtpërdrejtë kontribuon në ngritjen e aktiviteteve ekonomike gjithashtu dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe pse ky segment dallon nga Mikro Bizneset për nga struktura organizative, gjegjësisht rezulton me një strukturë më komplekse, stafi ynë ka arritur të ngrit nivelin e shërbimit tek Bizneset e këtij segmenti. Tek kjo kategori e bizneseve kemi tendencë më të madhe në nxitjen e formalizmit dhe qeverisjes efektive të korporatave të përcjellura me auditimin e pasqyrave financiare.

Produktet kreditore të ndryshme dhe me modalitete të diversifikuara janë ofruar kryesisht për financimin e kapitalit punues dhe kapital reprezentativ punues dhe njëkohësisht kreditë për asete fikse, renovim, ndërtim apo blerje të pasurive të paluajtshme.

Klientët individual

Në vazhdim të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve cilësore dhe profesionale për klientët individual, Banka Ekonomike gjatë vitit 2014 ka arritur të përmbyllë me sukses procesin e specializimit të këshilltarëve personal në ofrimin e kredive për këtë segment të klientëve. Me këtë kemi arritur që klientët individual të shërbehen nga këshilltarët personal për të gjitha produktet dhe shërbimet bankare në mënyrë të shpejtë, cilësore dhe profesionale.

Banka Ekonomike është kujdesur që relacioni me klientët ekzistues dhe ata potencial të rritet/krijohet duke u bazuar në identifikimin sa më të saktë të nevojave, kërkesave dhe pritshmërive të klientëve përkatës. Këtë e kemi arritur duke u bazuar në marrëdhënien e shëndoshë dhe korrekte me klientët dhe trajtimin me kujdes të të gjitha zhvillimeve duke qenë në hap me ndryshimet dhe avancimet njerëzore dhe teknologjike.

Gjatë vitit 2014 kemi arritur që numri i klientëve të bankës të rritet për 9.3% e kjo ka qenë edhe si rezultat i shërbimeve të ofruara dhe të qenurit konkurrent në treg, çka ka ndikuar edhe në besimin e klientëve për të shfrytëzuar shërbimet dhe produktet tona. Krahas rritjes së numrit të klientëve në vitin 2014 kemi edhe rritje të portfolios kreditore për 20%, një rritje e cila është përcjellur me dëshminë se banka është e orientuar në mbështetjen e klientëve për realizimin e qëllimeve të tyre, gjithnjë kur këto qëllime janë të arritshme, arsyeshme, dhe kanë si rezultat përmirësimin e standardit të jetës për klientët dhe familjet e tyre dhe rritjen e pasurisë/aseteve të tyre në planin afatgjatë.

Dëshmia se klientët kanë besim në Bankën Ekonomike janë niveli i depozitave dhe rritja e tyre gjatë viteve në vazhdimësi. Me këtë, duke qenë e vetmja bankë me kapital 100% vendor, mburremi dhe në të njëjtën kohë kemi përgjegjësi të lartë për aktivitetin dhe performancën e bankës në përgjithësi.

Zhvillimi i produkteve dhe Marketingu

Me zhvillimin dhe avancimin e teknologjisë, gjithmonë lindë nevoja për zhvillime të produkteve ekzistuese dhe produkteve të reja inovative. Në vazhden e këtyre zhvillimeve, vlen të ceket lansimi i POS terminaleve, ku tani klientët kanë mundësi të kryejnë pagesa në POS-a të bankës. Vendosja e POS terminaleve është bërë në pikat më strategjike dhe në këtë mënyrë është katërfishuar numri i transaksioneve.

Po ashtu u punua, në faktorizimin e kredit kartelës Master Card me opsionin e ndarjes së pagesës deri në 18 këste; ky produkt u zhvillua në bashkëpunim me rrjetin e shitësve bashkëpunëtorë të bankës që mbajnë POS terminalalet tona, dhe u mundëson klientëve që çdo pagesë me Master Card të lëshuar nga Banka Ekonomike, të ndahet në këste pa kamatë për klientin (deri në 18 këste të barabarta) me ç'rast ndodhë përfitim multi-dimensional ku blerësi e zgjatë afatin e pagesës ndërsa banka e krediton shitësin, si dhe blerësi/poseduesi i kartelës tonë po ashtu edhe fiton bonus për blerje.

Për më shumë u punua dhe akoma punohet në përmirësimin, zhvillimin dhe shtimin e veçorive/mundësive të reja në shërbimin e e-banking, ku tani klientët kanë mundësi edhe të kryejnë pagesat komunale, pagesat për Korporatën energjetike të Kosovës (KEK), Postë Telekomin e Kosovës etj. gjë që e ka përmirësuar dukshëm shërbimin e klientelës gjatë shfrytëzimit të këtyre shërbimeve dhe e ka rritur në përgjithësi efikasitetin e punës dhe që si rezultat ka pasur rritje mbi 35% të shfrytëzuesve të e-banking.

Një ndër pjesët tjera kyçe të afarizmit të suksesshëm duke ndikuar në krijimin e imazhit pozitiv në sektorin bankar është Marketingu.

Banka Ekonomike si një nga bankat më të vjetra në vend, ka krijuar identitetin e saj në sektorin bankar, duke krijuar kështu marrëdhënie të ndërsjella të besueshme me klientët e vet, përgjatë gjithë këtyre viteve të operimit në tregun bankar.

Për të mbajtur dhe forcuar marrëdhëniet reciproke të besueshme, është e nevojshme të kemi një komunikim të vazhdueshëm me klientët tanë, i cili lejon klientët të kuptojnë karakteristikat dhe vlerat e të gjitha produkteve dhe shërbimeve që banka ju ofron atyre.

Banka Ekonomike në vitin 2014 ka dizajnuar dhe plasuar kampanja të vazhdueshme me kushte atraktive për klientët e saj, këto kampanja kanë qenë të fokusuara kryesisht në kredi individuale dhe kredi biznesi, gjithashtu në pako me kredi janë dhuruar edhe produkte/shërbimet si Flexi Karte, E-Banking, SMS- Banking, në bazë të treguesve financiar të fund vitit mund të i vlerësojmë si kampanja mjaft të suksesshme.

Fokusi i veçantë ka qenë edhe rritja e prezencës duke bërë forcimin dhe identifikimin e kanaleve të reja të marketingut, një nga format më të avancuara sot të reklamimit është pa dyshim marketing online, gjë që edhe për Bankën Ekonomike ka qenë një nga kanalet më prioritare të reklamimit, duke mos përrjashtuar edhe kanale të tjera të komunikimit me klientët tanë dhe ata potencial.

Banka Ekonomike do të vazhdojë të veprojë si bankë 100% vendore, duke ofruar produkte inovative klientëve të saj.

Kanalet e distribuimit

Rrjeti i Degëve

Banka Ekonomike posedon një rrjetë të gjerë të Degëve dhe nëndegëve të saj, me të cilën ju mundëson klientëve të saj qasje sa më të lehtë në kryerjen e shërbimeve bankare. Viti 2014 në Bankën Ekonomike është karakterizuar në rifreskimin e njohurive të stafit të saj, me qëllim të bartjes së njohurisë në formë të këshillave ndaj klientëve konform nevojave të klientit. Një fokus të veçantë Banka i ka kushtuar kujdesit ndaj klientëve të saj.

Në mënyrë që të kemi edhe një kanal të ofrimit të shërbimeve kreditore kemi implementuar edhe “Call Center” shërbimin i cili merret me njoftimin e klientëve për ofertat e reja nga Banka Ekonomike dhe në mënyrë të vazhdueshme shërben kategorinë e klientëve potencial për kredi.

Gjatë vitit që po lëmë pas Banka Ekonomike ka analizuar kërkesat e klientëve duke ndikuar në infrastrukturën e degëve me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për kryerjen e shërbimeve nga ana e klientit.




Figura 11: Numri i degëve dhe nëndegëve, 2013-2014;




Figura 12: Pjesëmarrja në tregun bankar



Kanalet alternative të distribuimit

Qendra e thirrjeve e Bankës Ekonomike edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar të ofroj shërbime 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, shërbime të karakterit këshillues dhe informues. Gjatë vitit 2014 Banka Ekonomike ka analizuar rrjetin e Bankomatëve me ç'rast kemi rialokuar disa bankomatë me qëllim të ofrimit të qasjes sa më të lehtë të klientëve tanë. Gjithashtu, Banka gjatë vitit 2014 është fokusuar që pikat e shitjes apo POS Terminalet të i ri-

alokoj tek tregtarët që frekuentohen më shumë nga klientët.

Në vijim është paraqitur raporti i transaksioneve të kanaleve alternative të krahasuara për vitet 2013 dhe 2014. Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, numri i transaksioneve në ATM është rritur nga 315 mijë në 374 mijë Euro, numri i transaksioneve në POS nga 2,007 në 9,210, megjithatë mbetet ende në nivel të ulët, rrjedhimisht kjo do të jetë një nga prioritetet tona.




Figura 13: Raporti i transaksioneve nga kanalet alternative ,2013-2014;

Kujdesi ndaj klientëve

Kërkesat dhe nevojat e klientëve ndryshojnë vazhdimisht, andaj Banka Ekonomike çdo vit synon të tejkaloj pritjet e klientëve me ç'rast ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Banka Ekonomike gjatë vitit 2014 ka qenë e vendosur të ofroj shërbime kualitative, të shpejta dhe në çdo kohë mirësjellje të gjithë klientëve të saj, andaj

ka krijuar Njësinë e Kujdesit ndaj Klientëve në mënyrë që të siguroj procesim efektiv të sugjerimeve të klientëve. Trajtimi i shpejtë i sugjerimeve të klientëve dhe përmirësimi i proceseve ka qenë thelbësore për mbajtjen e biznesit konkurrues dhe klientëve të kënaqur. Banka Ekonomike është e vendosur edhe gjatë viteve të ardhshme që të punoj në krijimin e kushteve që do të ndikoj në pritshmërinë e klientëve tanë.



Menaxhimi i riskut

Gjatë vitit 2014, Banka Ekonomike ka ndërtuar politika dhe strategji për menaxhimin e riskut në nivel të bankës. Përmirësimi i kontrolleve të brendshme nëpërmjet centralizimit të disa proceseve ka ndikuar në zvogëlimin e të gjitha risqeve, me theks të veçantë ulje të riskut kreditor. Jetësimi i politikave të reja me qëllim të diversifikimit të riskut në favor të segmentit retail (shitje me pakicë)

është përcjellë në specializimin e resurseve për këtë segment. Rol të rëndësishëm ka luajtur diversifikimi i portfolios në të gjithë segmentet dhe monitorimi dhe kufizimi i kredidhënies në sektor të caktuar. Niveli i provizionimeve të akumuluar është mbajtur nën kontroll, dhe janë angazhuar resurse shtesë për monitorim dhe inkasim të kredive joperformuese.

Euro '000	2010	2011	2012	2013	2014
Rezervat e reja	-4,050	-3,829	-6,293	-4,055	-4,935
Inkasimet 180 +	994	671	636	2,628	1,929
Rezervat Neto	-3,056	-3,158	-5,657	-1,427	-3,006




Figura 14: Niveli i Rezervave Neto nga Kredit, 2010-2014

Risku Kreditor

Struktura e riskut kreditor azhurnohet rregullisht në lidhje me procesin e identifikimit, monitorimit, dhe matjes së riskut të kredive në kohë, së bashku me metodologjinë, proceset dhe programet që lidhen me të. Gjatë vitit 2014 banka vazhdoi të zbatojë politika të matura të huadhënies, duke theksuar standarde të përshtatura për vlerësimin dhe monitorimin e ekspozimit të kreditit. Këto politika janë rishikuar gjatë fund vitit të 2014. Vlerësim i detajuar i riskut bëhet për çdo vendim në lidhje me aprovimin e produkteve kreditore.

Banka monitoron vazhdimisht nivelin e riskut kreditor, nëpërmjet limiteve rregullatore dhe të brendshme të vendosura dhe sigurohet që ekspozimi ndaj riskut të kreditit të jetë brenda limitit të bankës konform kërkesave që dalin nga direktivat e rregullatorit. Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të sistemeve të brendshme për të mbështetur procesin e përgjithshëm.

Synimi që banka të përgatitët me përfshirjen e standardeve më të larta të kapitalit është jetësuar me ndarjen e segmenteve të kreditimit në nën-segmente të veçanta më qëllim të diversifikimit dhe monitorimit më të afërt të të gjithë parametrave të riskut.

Ekspozimi nga rreziku i normës së interesit

Banka e menaxhon rrezikun e normave të interesit nëpërmjet hendekut të normave të interesit dhe më pas bën rregullimet për kohëzgjatjen e ndryshuar.

Analiza e ndjeshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose rënies së normave të interesit në treg dhe raporti i rivlerësimit dhe hendeku me lëvizje të normave të interesit me pika bazë. Skenarët standard, që konsiderohen mbi baza mujore, përfshijnë një rritje dhe rënie paralele me pikë bazë të të gjitha kurbave të interesit.

Risku Operacional

Duke filluar nga muajit Korrik 2014 Banka Ekonomike ka dizajnuar dhe ka vene në funksion modulën për regjistrim, identifikim, raportim të incidenteve operacionale. Stafi është trajnuar për identifikimin, raportimin e incidenteve dhe niveli i vetëdijesimit është rritur.

Transferet vendore

Banka Ekonomike ka vazhduar të ofroj shërbime të transaksioneve gjegjësisht qarkullimin e pagesave vendore në kuadër të Divizionit të Pagesave dhe Operacioneve. Duke pas fokus të veçantë dhe duke synuar gjithmonë optimizimin e proceseve, vazhdimësia e këtij segmenti ka derivuar rezultate të kosiderueshme.

Shuma totale e transfereve përmes sistemit të pagesave kombëtare ka qenë 616,979,391 EUR, ku nga këto transfere kombëtare hyrëse kanë qenë 253,770,504 EUR, ndërsa transferet kombëtare dalëse kapin shumën prej 363,208,887 EUR apo 11% rritje në krahasim me vitin 2013.




Figura 15: Transferet Kombëtare, Hyrëse dhe Dalëse;
Të gjithë numrat janë në '000 Euro!

Transferet ndërkombëtare

Krahas transfereve vendore Banka Ekonomike i ka dhënë po aq rëndësi edhe zhvillimit dhe përmirësimit të procesimit të pagesave ndërkombëtare. Në këtë drejtim gjatë vitit 2014 është implemetuar SWIFT KODI i cili ka thjeshtuar tej mase procesin e transaksioneve të këtij segmenti. Vlera

e përgjithshme e qarkullimit të transfereve ndërkombëtare në fund të vitit 2014 ka qenë 169,605,515 EUR, nga këto transfere ndërkombëtare hyrëse kanë qenë 99,969,862 EUR apo krahasuar me vitin 2013 ka shënuar rritje prej 3%, kurse transfere dalëse kanë qenë 69,635,653 EUR apo krahasuar me vitin 2013 kanë shënuar rritje prej 0.92%.




Figura 16: Transferet Ndërkombëtare, Hyrëse dhe Dalëse; Të gjithë numrat janë në '000 Euro!

Letërkreditë dhe garancionet ndërkombëtare

Banka Ekonomike shfrytëzon plasmanët në Bankat korrespondente edhe për realizimin e Letërkredive dhe Garancioneve bankare ndërkombëtare.

Në vitin 2014 shuma totale e Garancioneve dhe Letërkredive ndërkombëtare të lëshuara arriti në 1,902,018.33 EUR apo rreth 3% më pak se viti 2013, ndërsa numri i Garancioneve dhe Letërkredive të lëshuara kishte rritje prej 5% krahasuar me 2013.




Figura 17: Garancione dhe Letërkredi ndërkombëtare; Të gjithë numrat janë në '000 Euro!

Teknologjia Informative

Mbështetja e Teknologjisë Informative është konsideruar gjithmonë nga Banka Ekonomike si një faktor i rëndësishëm në strategjitë e saj për sukses. Kjo mbështetje është kanalizuar kryesisht në reduktimin e risqeve, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe reduktimin e kostove operative për të gjithë Bankën.

Departamenti i Teknologjisë Informative është përgjegjës për mirëmbajtjen e infrastrukturës informative të Bankës, organizimin, realizimin dhe zhvillimin e projekteve në bashkëpunim me Departamentet e tjera. Gjatë kësaj periudhe, ky Departament ka krijuar një infrastrukturë të brendshme, të mbështetur nga fjala e

fundit e teknologjisë, ka realizuar me sukses një sërë projektesh si dhe ka përmirësuar më tej shumë sisteme informative, ato që mund të përmenden janë lidhja me sukses në rrjetin SWIFT dhe implementimi i IBAN, të cilat direkt kanë ndihmuar dhe lehtësuar procesimin e shpejtë të transfertave dhe shërbimeve ndaj klientit.

Gjatë vitit 2014 Departamenti Teknologjisë Informative ka përfunduar me sukses testimin e planit të Vazhdimësisë së Biznesit. Në një periudhë të shkurtë Banka do të lansojë platformën e re e-banking e cila do t'i përmbush të gjitha kërkesat e tregut dhe klientëve.

Menaxhimi dhe trajnimi i personelit

Departamenti i Burimeve Njerëzore i kushton vëmendje të veçantë procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punëtorëve kompetent për ti plotësuar pozitat specifike në bankë, ku si rezultat i është dhënë mundësia një numri të punëtorëve të brendshëm në nivel të Degëve dhe Departamenteve që të avancohen në pozita të reja, duke u bazuar në aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre.

Departamenti i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2014 ka bërë ndryshimin e vlerësimit të performancës duke implementuar formën e re të MBO-ve për punëtorët e Bankës.

Banka Ekonomike për të gjithë punëtorët ofron sigurimin shëndetësor dhe aksidental. Gjatë vitit 2014, angazhimi më i madh i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka qenë që t'iu ofrojmë trajnime të vazhdueshme punëtorëve, sepse besojmë se kompetenca dhe angazhimi i punëtorëve tonë është vendimtar për ofrimin e shërbimeve cilësore për klientë tanë. Punëtorët e Bankës Ekonomike kanë marrë pjesë në trajnime edhe jashtë vendit, gjë e cila tregon rëndësinë që Banka Ekonomike i kushton integritetit të punëtorëve dhe zhvillimit të tyre profesional në tregun bankar.

<i>Vitet</i>	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i punëtorëve ndër vite	354	386	352	303	321

Banka Ekonomike Sh.a.

Pasqyrat financiare të përgatitura sipas rregullave dhe rregulloreve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (Rregullat e BQK-së) dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2014

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur 36

Pasqyra e pozitës financiare 38

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse 39

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar 40

Pasqyra e rrjedhës së parasë 41

Shënimet e pasqyrave financiare 42

Raporti i auditorit të pavarur



Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për menaxhmentin dhe aksionarët e Bankës Ekonomike Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Bankës Ekonomike Sh.a (“Banka”), ku përfshihet Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2014, dhe Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe informatave tjera shpjegues.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës (“BQK”) siç është shpjeguar në shënimin 2, dhe për kontrollin e brendshëm të tillë siç menaxhmenti përcakton se është e nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim lidhur me pasqyrat financiare bazuar në auditimin e bërë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova lidhur me shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e selektuara për auditim varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut për gabime materiale në pasqyrat financiare qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, auditori merr parasysh kontrollat e brendshme relevante në përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Bankës, në mënyrë që të dizajnoj procedurat e duhurat të auditimit në rrethana të caktuara, por jo për të shprehur një mendim lidhur me efektivitetin e kontrolleve të brendshme të bankës. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e politikave të duhura të kontabilitetit të përdorura si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin dhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar baza për opinion të kualifikuar.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë veten për përshtatshmërinë e të ardhurave nga tarifat dhe të komisioneve për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2013 dhe të balances së të ardhurave të shtyra nga kreditë dhe mbitërheqjet më 31 dhjetor 2013. Pasi që balanca fillestare e të ardhurave të shtyra ndikon në përcaktimin e rezultateve të operacioneve, ne nuk kemi qenë në gjendje për të përcaktuar nëse rregullimet në rezultatet e operacioneve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 dhe hapja e balancës së humbjeve të akumuluar më 1 janar 2014 mund të jenë të nevojshme.

Banka gjatë vitit 2014 dhe vitit 2013 ka përmirësuar njohjen e të hyrave nga tarifat dhe komisioneve. Mëgjithatë, gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur gabime në lidhje me llogaritjen e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet për kreditë dhe mbitërheqjet të lëshuara para vitit 2013. Për shkak të natyrës së regjistrave të bankës, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar shumën e rregullimeve për të ardhurat nga tarifat dhe komisionet të regjistruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe të ardhurave të shtyra më 31 dhjetor 2014.

Opinionit i Kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës siç shpjegohet në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
16 prill 2015

Ky raport është përkthim i versionit original në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotëroj versionin në gjuhën angleze.

Pasqyra e pozitës financiare

Shënimet			(Në 000 Euro)
	Më 31 dhjetor		Më 1 janar
	2014	2013	2013
		Riparaqitur	Riparaqitur

Pasuritë

Paraja në dorë dhe në banka	5	15,403	14,535	16,477
Balancat me BQK-në	6	10,915	38,095	24,657
Kreditë e dhëna klientëve	7	110,812	103,890	94,794
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	8	28,141	13,934	10,852
Prona dhe paisjet	9	6,388	6,957	7,580
Pasuria e paprekshme	10	306	68	109
Parapagimet për tatimin mbi të ardhurat e korporatës		146	228	204
Pasuria e tatimit të shtyrë		-	117	-
Pasuritë tjera	11	586	506	788
Gjithsej pasuritë		172,697	178,330	155,461

Detyrimet

Depozitat e klientëve	12	157,353	164,631	142,879
Borxhet e varura	13	1,050	-	-
Të hyrat e shtyra		331	559	454
Llogaritë e pagueshme	14	409	528	725
Gjithsej detyrimet		159,143	165,718	144,058

Kapitali dhe rezervat

Kapitali aksionar	15	14,778	14,778	14,778
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	16	102	102	102
(Humbjet) e akumuluar		(1,326)	(2,268)	(3,477)
Gjithsej kapitali dhe rezervat		13,554	12,612	11,403
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		172,697	178,330	155,461

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Bankës dhe nënshkruar në emër të saj më 16 prill 2015:

Znj. Merita Gjyshinca Peja
Menaxhere e Përgjithshme

Znj. Syzane Kaçaniku
Menaxhere e Financave

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Shënimet	(Në 000 Euro)	
	Për vitin që përfundon më	
	31 dhjetor	
	2014	2013 Riparaqitur

Të hyrat nga interesi:

Nga kreditë e dhëna klientëve		12,610	12,794
Nga depozitat dhe balancat me bankat		2	13
Interesi nga investimet e mbajtura deri në maturim		326	142
Gjithsej të hyrat nga interesi		12,938	12,949

Shpenzimet e interesit			
Nga depozitat e klientëve		(4,066)	(5,557)
Borxhi i varur		(50)	-
		(4,116)	(5,557)
Neto të hyrat nga interesi		8,822	7,392

Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	17	2,491	2,048
Shpenzimet nga komisionet dhe tarifat		(396)	(276)
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat		2,095	1,772

Të hyrat tjera operuese	18	48	33
(Humbjet) / fitimet neto nga valutat e huaja		(6)	28
Gjithsej të hyrat		10,959	9,225

Shpenzimet tjera operuese	19	(6,994)	(6,828)
Provizionimi për humbjet nga kreditë	7	(2,897)	(1,305)
Gjithsej shpenzimet operuese		(9,891)	(8,133)

Fitimi para tatimit		1,068	1,092
Tatimi mbi të ardhurat	20	(127)	117
Neto fitimi për vitin		941	1,209

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		941	1,209

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar

(Në 000 Euro)	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme e rrezikut	(Humbja) e akumuluar	Gjithsej kapitali
Më 01 janar 2013 (sipas raportimi paraprak)	14,778	102	(3,338)	11,542
Korrigjimi gabimeve (referohuni shënimit 4)	-	-	(139)	(139)
Me 01 Janar 2013 (riparaqitur)	14,778	102	(3,477)	11,403
<i>Transaksionet me pronarët</i>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	1,209	1,209
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	1,209	1,209
Më 31 dhjetor 2013 (riparaqitur)	14,778	102	(2,268)	12,612

Më 01 janar 2014 (riparaqitur)	14,778	102	(2,268)	12,612
<i>Transaksionet me pronarët</i>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	942	942
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	942	942
Më 31 dhjetor 2014	14,778	102	(1,326)	13,554

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	(Në 000 Euro)		
	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor		
	Shënimet	2014	2013 Riparaqitur
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,068	1,092
Rregullimet për:			
Amortizimi dhe zhvlerësimi		1,009	997
Neto provizionet për humbjet nga kredit e dhëna klientëve		2,897	1,305
Lirimi i Provizioneve për humbjet nga detyrimet kontigjente		(22)	(2)
Shlyrjet e parapagimi të tatimit mbi të ardhurat		33	-
Humbjet nga heqjet e pronës dhe pajisjeve		5	27
Të hyrat nga interes		(12,938)	(12,950)
Shpenzimet e interes		4,116	5,557
(Humbja) para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		(3,832)	(3,974)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Balancat e kufizuara me BQK-në		(934)	(2,201)
Kreditë e klientëve		(10,035)	(10,376)
Pasuritë tjera		(80)	302
Depozitat nga klientët		(7,196)	21,689
Borxhet e varura		1,000	-
Detyrimet tjera		(96)	(251)
Të hyrat e shtyra		(228)	105
(Humbja) / Fitimi pas ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		(21,401)	5,294
Intereset (e paguara)		(4,148)	(5,494)
Intereset e arkëtuara		13,010	12,922
Tatimi mbi të ardhurat (i paguar)		49	(24)
Neto paraja nga/(përdorur në) aktivitetet operative		(12,490)	12,698
Aktivitetet investive			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme		(683)	(330)
Blerja e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim, neto		(14,073)	(3,073)
Neto paraja (e përdorur në) aktivitetet investive		(14,756)	(3,403)
Aktivitetet financiare			
Rritja e kapitalit aksionar		-	-
Neto paraja nga aktivitetet financiare		-	-
Neto ndryshimi në para dhe ekuivalentet e parasë		(27,246)	9,295
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim të vitit		41,744	32,449
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit	5	14,498	41,744

Shënimet e pasqyrave financiare

1 Informacione të përgjithshme

Banka Ekonomike Sh.a Prishtinë (më tej e referuar si “Banka”) është një Shoqëri Aksionare e inkorporuar në Republikën e Kosovës. Adresa e selisë kryesore është Sheshi Nënë Tereza, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhshmëri me Bankën Qendrore të Kosovës (“BQK”), Banka Ekonomike Sh.a Prishtinë (“Banka”) mori licencën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 maj 2001 dhe filloi operimin e saj më 5 qershor 2001. Banka operon njëkohësisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

2 Baza e përgatitjes

Banka mirëmbanë librat kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhshmëri me koston historike dhe rregullat e rregulloret kontabël të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (“rregulloret e BQK-së”) që janë të aplikueshme për bankat. Rregulloret e BQK-së janë të bazuara në vendimet legale relevante që definojnë aplikimin e obligueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) në Kosovë, por rregulloret e BQK-së gjithashtu kërkojnë në mënyrë specifike aplikimin e trajtimeve kontabël që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e SNRF. Si pasojë, këto pasqyra duhet të lexohen (interpretohen) si të përgatitura në përputhshmëri me standardet e kontabilitetit dhe rregulloret që mbizotërojnë në territorin e Kosovës që janë shpalosur në politikat kryesore të kontabilitetit në Shënimin 3 më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhshmëri me rregulloret e BQK-së, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe parashikime që ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, në shpalosje të pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare, dhe shumën e raportuar të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Edhe pse këto vlerësime janë të bazuara në njohuritë më të mira të menaxhmentit për ngjarjet e tanishme dhe veprimet, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Pasqyrat financiare janë përgatitur më dhe për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese në këto pasqyra financiare janë të paraqitura në mija Euro. Ku ka qenë e nevojshme, figurat krahasuese janë rregulluar konform me ndryshimet në prezantimin e vitit aktual.

2.1 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

2.1.1 Standardet e reja dhe të ndryshuara që janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014

Një numër i standardeve të reja dhe të rishikuara janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014. Informacionet për këto standarde të reja janë paraqitur më poshtë.

KIRFN 21 'Ngarkesat'

KIRFN 21 sqaron se:

- ngjarja obliguese që krijon një detyrim është aktiviteti që shkakton pagesën e ngarkesës, siç është identifikuar nga legjislacioni qeveritar. Në qoftë se ky aktivitet ndodhë në një datë specifike brenda një periudhe kontabël, atëherë i tërë detyrimi njihet në atë datë.
- të njëjtat parime të njohjes vlejné edhe në pasqyrat financiare vjetore dhe ato të ndërmjetme.

KIRFN 21 nuk ka asnjë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

Kundërbalancimi i asetëve financiare dhe detyrimeve financiare (Ndryshimet në SNK 32)

Këto ndryshime sqarojnë zbatimin e kriterëve të caktuara të kundërbalancimit në SNK 32, duke përfshirë:

- kuptimin e 'aktualisht ka një të drejtë të ekzekutueshme ligjore për kundërkompensim';
- atë të disa mekanizma të shlyerjes bruto mund të konsiderohen të barasvlershëm me shlyerjen neto.

Ndryshimet janë zbatuar në mënyrë retrospektive në përputhje me dispozitat e tyre kalimtare. Meqë pasqyrat financiare të Bankës aktualisht nuk paraqesin asnjërën nga asetet financiare apo detyrimet financiare të saj mbi bazën neto duke përdorur dispozitat e SNK 32, këto ndryshime nuk patën efekt material për asnjërën nga periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Bankës.

Shpalosja e shumave të rikuperueshme për asetet jofinanciare (Ndryshimet në SNK 36)

Këto ndryshime sqarojnë se një entitet kërkohet të shpalosë shumën e rikuperueshme të një asemi (ose të një njësie që gjeneron mjete monetare) sa herë që një humbje nga dëmtimi është njohur ose është anuluar në atë periudhë. Përveç kësaj, ndryshimet paraqesin disa shpalosje të reja që kërkohen në rastet kur shumata e rikuperueshme e asetëve të dëmtuara bazohet në vlerën e drejtë minus kostot e hudhjes, duke përfshirë:

- informacione shtesë për matjen e vlerës së drejtë, duke përfshirë nivelin përkatës hierarkik të vlerës së drejtë, dhe një përshkrim të çdo teknike të përdorur të vlerësimit dhe supozimet kryesore të bëra;
- normat e skontimit që përdoren në qoftë se vlera e drejtë minus kostot e hudhjes matet duke përdorur teknikën e vlerës aktuale.

Këto ndryshime zbatohen në mënyrë retroaktive në përputhje me dispozitat e tyre kalimtare. Zbatimi i SNK 36 nuk ndikon në pasqyrat financiare të Bankës.

2.1.2 Miratimi i hershëm i 'Skemat me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve (Ndryshimet në SNK 19)

Ndryshimet në SNK 19 kanë bërë disa ndryshime në kontabilizimin e përfitimeve të punonjësve. Këto ndryshime vlejné për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2014 dhe:

- sqarojnë kërkesat e SNK 19 që kanë të bëjnë me kontributet nga punonjësit ose palët e treta

- paraqesin një matje praktike të tillë që kontributet të cilat janë të pavarura nga numri i viteve të shërbimit mund të trajtohen si ulje e kostos së shërbimit në periudhën në të cilën është kryer shërbimi përkatës.

Zbatimi i SNK 19 nuk ndikon në pasqyrat financiare të Bankës.

2.1.3 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe të cilat nuk janë adoptuar para kohës nga Banka

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK por nuk janë ende në fuqi, dhe nuk janë adoptuar para kohës nga Banka.

Menaxhmenti parashikon që të gjitha shpalljet relevante do të adoptohen në politikat kontabël të FKPK-së në periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes së tyre. Informacionet për standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që pritet të jenë relevante për pasqyrat financiare të FKPK-MP prezantohen më poshtë. Disa standarde dhe interpretime të tjera të reja janë shpallur por nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 9 Instrumentet financiare (2014)

BSNK së fundmi ka nxjerrë SNRF 9 'Instrumentet Financiare' (2014), që paraqet përfundimin e projektit të tij për zëvendësimin e SNK 39 'Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja'. Standardi i ri bën ndryshime të shumta në udhëzimet e SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e asetëve financiare si dhe paraqet një model të ri të 'humbjes së pritur kreditore' për asetet e dëmtuara financiare. SNRF 9 po ashtu parashtron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti i Bankës mbetet që të bëjë vlerësimin e ndikimit të SNRF 9 në këto pasqyra financiare. Standardi i ri kërkohet të zbatohet për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientë

SNRF 15 paraqet kërkesa të reja për njohjen e të hyrave, duke bërë zëvendësimin e SNK 18 'Të hyrat', SNK 11 'Kontratat e ndërtimit', si dhe disa interpretime që kanë të bëjnë me të hyrat. Standardi i ri përcakton një model të njohjes së të hyrave të bazuar në kontroll dhe siguron udhëzime shtesë në shumë fusha të pa mbuluara me SNRF-të ekzistuese, duke përfshirë se si të kontabilizohen aranzhimet me detyrime të kryerjes të shumëfishta, çmimimet variabile, të drejtat e klientit për rimbursim, opsionet e furnizuesit për riblerje si dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

SNRF 15 vlen për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Zbatimi i SNRF 15 nuk ndikon në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në SNRF 11 Aranzhimet e Përbashkëta

Këto ndryshime japin udhëzime për kontabilizim të blerjes së interesave në operacionet e përbashkëta të cilat përbëjnë një biznes. Ndryshimet kërkojnë që të gjitha transaksionet e tilla të kontabilizohen duke përdorur parimet për kontabilizimin e kombinimeve të biznesit në SNRF 3 'Kombinimet e Biznesit' dhe SNRF-të e tjera përveç ku ato parime janë në kundërshtim me SNRF 11. Blerjet e interesave në sipërmarrjet e përbashkëta nuk ndikohen nga ky udhëzim i ri.

Ndryshimet vlejnë për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Zbatimi i SNK 11 nuk ndikon në pasqyrat financiare të Bankës.

3 Politikat e rëndësishme kontabël

3.1 Monedha e prezantimit

Monedha e raportimit të Bankës është Euro e cila është monedha legale ne Territorin e Kosovës që nga data 01 janar 2002.

3.2 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit bazuar në çmimin aktual të blerjes, përveç për kreditë ku mbledhja është e pasigurtë, të hyrat nga interesi njihen në baza të keshit.

3.3 Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregulloret e BQK-së, Banka duhet të arrijë mesataren minimale të kërkesave të likuiditetit. Kërkesat e likuiditetit janë të përlogaritura në baza mujore si 10% e depozitave bazë, e përcaktuar si mesatare totale e detyrimeve ndaj depozitave në pjesën jo-bankare-publike në Euro dhe monedhave tjera gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat për likuiditetin e saj janë Euro depozitat me BQK-në dhe 50% e ekuivalentëve të parasë të denominuara në valuta lehtë të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më të ulëta se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme.

Përderisa asetet përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për financim të operacioneve të përditshme bankare, ato nuk janë përfshirë te paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të rrjedhës së parasë.

3.4 Të hyrat nga tarifat dhe komisionet

Tarifat dhe komisionet njihen përgjithësisht në baza akruale kur shërbimi është ofruar. Tarifat e zotimeve të kredisë për kreditë që kanë gjasa të tërhiqen shtyhen (së bashku me kostot direkte) dhe njihen si një rregullim i normës efektive të interesit në kredi

3.5 Kreditë e klientëve

Kreditë e lëshuara nga Banka duke u siguruar paratë drejtpërdrejtë huamarrësve janë kategorizuar si kredi ndaj klientëve.

Kreditë e lëshuara dhe paradhëniet njihen në momentin kur paratë u lëshohen huamarrësve. Fillimisht, kreditë e lëshuara dhe paradhëniet janë të regjistruara sipas kostos, e cila është vlera e tregut e pagesës së dhënë, dhe më pas janë mbajtur sipas kostos së amortizuar të zvogëluar për provizionin për kreditë e këqija.

Provizioni për rrezik të kredisë për kreditë e këqija është bërë në qoftë se ka prova objektive se banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat sipas kushteve kontraktuale. Shuma e provizionit përcaktohet në bazë të Rregullave të BQK-së e rregulluar për shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolaterali.

Provizioni për kreditë e këqija mbulon edhe humbjet e përgjithshme, ku ka dëshmi objektive se humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë llogaritur në bazë të modeleve historike të humbjeve në secilën komponentë, rangimit të kredive të caktuara për huamarrësit dhe reflektojnë mjedisin aktual ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Kur një kredi konsiderohet e paarkëtueshme, ajo shlyhet nga provizioni i caktuar për kreditë e këqija. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e domosdoshme janë ndërmarrë dhe shumat e humbjeve është përcaktuar. Mbulimet e mëvonshme të shumave të kredisë të cilat paraprakisht janë shlyer janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse shumat e provizionit për kreditë e këqija më vonë zvogëlohet si pasojë e ndonjë ngjarje pas shlyerjes, atëherë zvogëlimi i provizionit kreditohet në provizionin për shlyerjen e kredive në pasqyrën e të ardhurave.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Huat e konsumatorëve (vazhdim)

Në vazhdim kemi klasifikimin e kategorive dhe shkallet e provizioneve minimale siç është caktuar nga BQK-ja.

Kategoritë	Norma e provizionit
Nën-standarde	20%
Të dyshimta	50%
Humbje	100%

Përveç provizioneve specifike të kërkuara ndaj ekspozimeve të klasifikuara, Banka bën provizionimin e përgjithshëm ndaj portfolios të mbetur, jo të klasifikuar ose pjesëve të portfolios. Provizionimi i përgjithshëm, llogaritet si një përqindje ndaj portfolios të mbetur jo të klasifikuar.

3.6 Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja të ndryshme nga Euro regjistrohen sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rregullimi i transaksioneve të denominuara në valuta të huaja janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date.

Asetet monetare dhe detyrimet e denominuara në valuta të huaja janë shndërruar në Euro sipas vlerës mesatare të kursit të këmbimit në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo-monetar që janë denominuar në valuta të huaja që mbahen me vlerën e tyre të tregut, janë rishndërruar në valutën funksionale me normat e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e tregut. Zërat jo-monetar që janë matur sipas kostos historike në valutë të jashtme nuk janë rishndërruar në valutën funksionale. Fitimet dhe humbjet e valutave të jashtme që rrjedhin nga shndërrimi i aseteve dhe detyrimeve janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave si fitim nga shndërrimi i këmbimit i jashtëm i zvogëluar për humbjet.

3.7 Prona dhe paisjet

Patundshmëritë dhe paisjet janë vlerësuar në bazë të kostos duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionin për heqjet nga përdorimi, aty ku kërkohet. Kosto përfshinë shpenzimet që janë direkt të përfshira në blerjen e pasurive. Aty ku njësi të një pasurie ose paisjeje kanë vlerë të ndryshme të jetëgjatësisë, ato paraqiten ndaras si njësi të veçanta (komponentët më të mëdha) të pasurisë dhe pajisjeve.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pasurisë dhe paisjeve njihet në vlerën mbajtëse të njësisë, nëse pritet që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me njësinë të rrjedhin dhe kostoja e tyre të mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e pasurisë dhe paisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave ashtu siç ndodhin.

Zhvlërësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtëvizore bazuar në jetëgjatësinë e secilës pjese të pasurisë dhe paisjeve. Pasuritë me qira zhvlërësohen për një periudhë më të shkurtë bazuar në marrëveshjen për qira dhe jetëgjatësinë së tyre. Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

Kategoritë e pasurive	Jetëgjatësia
Kompjuterët dhe paisjet tjera të lidhura	5 vite
Veturat	5 vite
Mobiljet, instalimet dhe paisjet	5 vite
Ndërtesat	20 vite

Metodat e zhvlërësimit, jetëgjatësia dhe vlera reziduale rishikohen në fundvit dhe rregullohen.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Pasuritë e paprekshme

Softueri i blerë nga Banka është vlerësuar sipas kostos duke zbritur zhvlërësimin e akumuluar dhe humbjet e dëmtimeve të akumuluar. Shpenzimet e më pasme të softuerit kapitalizohen vetëm atëherë kur i rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat kanë të bëjnë. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në bazë të ndodhjes.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtëvizore duke u bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së softuerit, nga data që është futur në përdorim. Jetëgjatësia e softuerit konsiderohet të jetë dhjetë vite.

3.9 Humbja e vlerës së pasurive jo monetare

Rënia në vlerë e aktiveve të Bankës vlerësohet në bazë të dispozitave Ndërkombëtare të Kontabilitetit Standardi nr. 36 “Rënia në vlerë e Aseteve”. Ky standard kërkon që një humbje nga rënia në vlerë të njihet kurdoherë që vlera bartëse e një pasurie e tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e lartë e çmimit neto të shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera e tashme e rrjedhës së parasë që pritet të rrjedhë në të ardhmen nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga hedhja, shitja e saj.

3.10 Lizingu

Qiratë klasifikohen si qira financiare sa herë që kushtet e qirasë transferojnë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë të qiramarrësi. Të gjitha kontratat e tjera janë të klasifikuara si qeraoperative.

Pagesat e bëra nën qeratat operative njihen në fitim ose humbje sipas metodës lineare gjatë afatit të qirasë. Rritjet e pranuar janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale për qira, gjatë kohëzgjatjes të qirasë.

3.11 Tatimi

Tatimi është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, ligji nr. 03/L-162 “Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave”.

Tatimi mbi të ardhurat për vitin përfshinë tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë, nëse ka ndonjë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç raportohet në pasqyra sepse përjashton zëra të të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose zbritshme në vitet e tjera dhe kjo më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme. Tatimet tjera përveç tatimit në të ardhura janë të regjistruara brenda shpenzime operative.

Tatimi i shtyrë në të hyra është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të balancit të gjendjes për të gjitha ndryshimet e përkohshme që rrjedhin ndërmjet bazës së tatimit të pasurive dhe detyrimeve dhe shumave të tyre të bartura në pasqyrat financiar. Tatimi i shtyrë në detyrime është njohur për të gjitha ndryshimet e përkohshme të tatueshme, ndërsa tatimi i shtyrë- pasuri është njohur për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme mund të shfrytëzohen.

Vlera bartëse e tatimit të shtyrë në pasuri është rishikuar në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe është reduktuar në atë masë që nuk është më e mundshme që fitimi i tatueshëm përkatës të jetë në dispozicion që të lejoj që totali apo një pjesë e tatimit të shtyrë në të hyra - pasuri të jetë i shfrytëzueshëm.

Tatimi i shtyrë në pasuri dhe detyrime është matur me norma tatimore që pritet të zbatohet për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është i paguar. Tatimi i shtyrë debitohet ose kreditohet në fitim ose humbje, përveç kur ai lidhet me artikujt e debituar ose kredituar drejtpërdrejt në kapitalin e vet, në të cilin rast tatimi i shtyrë është trajtuar edhe në kapitalin neto.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Pasuritë dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen kur ka një të drejtë ligjore për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti organ tatimor si dhe Banka synon për të zgjidhur pasuritë e saj aktuale tatimore dhe detyrimet në një bazë neto.

3.12 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë njësi që mund të konvertohen në kesh me një lajmërim të shkurtër (më pak se tre muaj maturitet) dhe të cilat i ekspozohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimit në vlerë. Shumat të cilat janë të lidhura me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e parasë.

3.13 Asetet Financiare

Banka i klasifikon asetet financiare në kategoritë në vazhdim: asetet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, asetet financiare të mbajtura deri në maturitet dhe dhe të gatshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilën investimet ishin përvetsuar. Menaxhmenti përcakton klasifikimi e investimeve të veta fillestare të njohjes fillestare dhe ri-vlerëson këtë tek çdo datë e raportimit.

(a) Asetet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: aktivet financiare të mbajtura për tregtim dhe atyre të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aktiv financiar është klasifikuar në kategorinë “aktivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes” në fillim nëse merret kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, në qoftë se ajo formon

një pjesë të portofolit të aktiveve financiare në të cilat ka prova të afatshkurtër fitim-marrjen, ose në qoftë se kështu i caktuar nga menaxhmenti. Banka nuk ka asetë të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

(b) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë asetë financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv.

(c) Asetet financiare të mbajtura deri në maturim

Asetet Financiare të mbajtura deri në maturim janë asetet financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse të tjera përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme që Menaxhmenti i Bankës ka një synim pozitiv dhe aftësi për ta mbajtur deri në maturim. Banka ka investimin në bono thesari të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

(d) Asetet financiare në dispozicion për shitje

Asetet financiare në dispozicion për shitje janë asetë jo-derivative financiare që ose janë caktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në asnjë nga kategoritë e tjera. Banka nuk ka asetë të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

Njohja fillestare dhe mos-njohja

Blerjet dhe shitjet e asetëve financiare në mënyrë të rregullt njihen në datën e tregtimit - datën në të cilën Banka zptohet për të blerë ose shitur asetin. Asetet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha asetëve financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e tyre. Asetet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje të njihen me vlerën e drejtë, ndërsa kostot e transaksionit janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave. Asetet financiare çregjistrohen kur e drejta për të marrë flukset monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ato janë transferuar dhe Banka gjithashtu ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Asetet financiare (vazhdim)

Matja e mëposhme

Asetet financiare në dispozicion për shitje dhe asetet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mbahen më pas me vlerën e drejtë. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura deri në maturim janë asetë financiare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet e realizuara dhe të porealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të asetëve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën në të cilën ato ndodhin. Fitimet e porealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje njihen në kapital. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të disponueshme për shitje janë shitur ose kanë rënie të vlerës, rregullimet e akumuluar te vlerës së drejtë janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si fitimet / humbjet neto të realizuara nga asetet financiare.

Fitimet ose humbjet që dalin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të asetëve financiare me vlerë të drejtë të kategorizuara nëpërmjet fitimit ose humbjes janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si neto fitimet/humbjet e vlerës së drejtë në asetë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në periudhë në të cilën ato ndodhin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje njihen në kapital.

Interesi nga asetet financiare të klasifikuara si në dispozicion për shitje është llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Dividendët nga asetet financiare me interes në kapital të klasifikuara si në dispozicion për shitje të kapitalit njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur e drejta e Bankës për të marrë pagesa është themeluar. Të dyja janë të përfshira në linjen e të ardhurave të investimeve. Vlera e drejtë e investimeve të kuotuar janë të bazuara në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një aset financiar nuk është aktiv, Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknikat e vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të palidhura, referenca për instrumente të tjera që në thelb janë të njëjta, analiza e rrjedhës së parasë e diskontuar etj.

3.14 Humbja në vlerë e aseteve financiare

Asetet e mbajtura në koston e amortizuar

Banka vlerëson në çdo datë të pasqyrës se pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një aset financiar ose grup asetesh financiare është i zhvlerësuar. Një aset financiar ose grup asetesh financiare është i demtuar dhe humbjet nga demtimi kanë ndodhur vetëm nëse ka evidencë objektive demtimi si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të asetit (një "rast humbjeje") dhe se ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të asetit financiar ose grup asetesh financiare që mund të maten me besueshmëri.

Shuma e humbjes në vlerë matet si diferencë midis shumës së bartur të asetit dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme kreditore) skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të asetit financiar. Të arkëtueshme me maturitetet afatshkurtër nuk skontohen. Vlera e bartur e asetit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një lejimi për humbje në vlerë dhe vlera e humbjes në vlerë njihet në fitimet dhe humbjet e tanishme.

3.15 Detyrimet Financiare

Detyrimet financiare janë të klasifikuara në përputhje me marrëveshjen kontraktuale. Kostot e amortizuara në pasivet financiare përbehen nga borxhi i varur dhe detyrimet tjera.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Detyrimet financiare (vazhdim)

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime kapitale apo instrumente kapitale në përputhje me kushtet e marrëveshjeve kontraktuale për instrumentet perkatëse.

Borxhi i varur

Borxhi fillimisht njihet në vlerën reale të tij. Borxhi i varur pastaj analizohet me koston e amortizuar për gjatë periudhës. Borxhi i varur pastaj cregjistrohet në momentin e shlyesjes, anulimit apo skadimit të tij.

Detyrimet tjera

Detyrimet tjera njihen fillimisht në vlerën reale dhe më pas paraqiten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Detyrimet tjera cregjistrohen në momentin ndërprerjes së tyre, anulimit apo skadimit.

3.16 Zotimet jashtë - bilancore

Në rrjedhën e zakonshme të biznesit Banka hyn në zotime të lidhura me kredi, që janë të regjistruara në konto jashtë bilancore ku fillimisht përfshihen garancionet, letrat kreditore dhe kreditë e zotuara dhe të pa tërhequra. Këto angazhime financiare regjistrohen në pasqyrën e pozitës financiare të bankës vetëm kur këto bëhen të pagueshme. Provizionet për detyrimet e mundshme dhe detyrimet kontingjente të humbjeve bëhen sipas rregulloreve të BQK-së.

3.17 Përfitimet e puntorëve

Plani i definuar i kontributiveve pensionale

Banka bën vetëm kontribute të detyrueshme për sigurim social të cilat ofrojnë përfitime pensionale për punëtorët deri në pensionim. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për caktimin e pragut minimal të shumës për pensionet në Kosovë bazuar në një plan të definuar të kontributeve pensionale. Kontributet e Bankës për pensione hyjnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur të ndodhin.

Përfitimet afatshkurtra

Obligimet afatshkurtra për përfitimet e punëtorëve janë llogaritur në baza të padiskontuara (pazbritura) dhe shpenzohen kur shërbimi përkatës të jetë ofruar.

Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër në para ose si profit në planet pensionale përfituese, nëse Banka ka ndonjë detyrim ligjor ose të tërthortë për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punëtorët dhe detyrimi mund të matet besueshëm.

3.18 Gjykimet kritike kontabël dhe burimet për pasigurinë e vlerësimit

Në aplikimin e politikave kontabël të bankës, të cilat i kemi pershkruar më sipër, menaxhmentit i kerkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumën e aseteve dhe detyrimeve. Vlerësimet dhe supozimet e nderlidhura janë bazuar në përvojën historike si dhe në faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë si të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën rishikohet si dhe bëhet vlerësimi nëse ndikon vetëm në atë periudhë apo edhe në periudhat e ardhshme.

Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Gjykimet kritike kontabël dhe burimet për pasigurinë e vlerësimit (vazhdim)

Humbja në vlerë e huave për klientë

Në përcaktimin, nëse kredite të klientëve janë amortizuar në baza individuale, kerkohet që të bëhet vlerësimi i vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme të parasë nga portfolio i kredive dhe nga mbledhja e kolateraleve. Amortizimi vlerësohet në baza kolektive për kreditë e konsumatorëve që nuk mund të bëhet amortizimi individual, dhe për të mbuluar humbjet që kanë ndodhur mirëpo nuk kanë qenë të identifikuar tek huatë me amortizim individual. Në vitin aktual Banka ka përdorur modelin e humbjes mesatare për të përcaktuar nivelin e dispozitave të provizionit në grup. Menaxhmenti i Bankës është duke bërë vlerësimin për normave të provizionit në portfolio.

4 Korrigjimi i gabimeve të periudhës së mëparshme dhe riklasifikimet

Pasqyrat e mëposhtme paraqesin ndikimin e riparaqitjes retrospektive të pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bankës nga 01 Janar 2013 dhe 31 Dhjetor 2013, si dhe Pasqyrën e të Ardhurave për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2013. Përveq kësaj, shumat të caktuara nga viti i mëparshëm janë riklasifikuar në mënyrë që të përputhen me kërkesat për dhënie të informacioneve shpjeguese për vitin aktual.

Ndikimi në Pasqyrën e pozicionit financiar	Si është raportuar	Si është riparaqitur (riklasifikuar)	Riklasifikimi	Korrigjimi i gabimeve
Me 1 janar 2013				
Pasuritë tjera	731	788	-	57
